

VENDIM
Nr. 192, datë 14.5.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME GJIROKASTËR SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 14.5.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë (UK Gjirokastrë), me shkresën nr. 361 prot., datë 12.3.2021, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për rinovim licence”, dhe me shkresën nr. prot. 435/1, datë 9.4.2021, “Dërgim dokumentacioni plotësues për rinovim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencimin e shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura. Shoqëria ka paraqitur kërkesën për licencim për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, të UK Gjirokastrë, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) shoqëria UK Gjirokastrë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 51 875 banorë të Bashkisë Gjirokastrë;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Bashkim Tola, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Gjeologji Miniera, dega Shpim, në vitin 1997 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastrë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Gjirokastër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. me (NUIS: K43522604G), në kategoritë:

- a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor: Gentian Llogo;
- b) Drejtues teknik: Bashkim Tola.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. është Bashkia Gjirokastër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani